

ARSIMI FILLOR NËNTËVJEÇAR



**PROGRAM  
MËSIMOR**

**GJEOGRAFIA**

Në bazë të nenit 55 paragrafi 1 të Ligjit për organizimin dhe punën e organeve të administratës shtetërore („Gazeta Zyrtare e RM” nr. 58/00 dhe 44/02) dhe nenit 24 dhe 26 të Ligjit për arsim fillor („Gazeta Zyrtare e RM” nr. 44/95, 24/96, 34/96, 35/97, 82/99, 29/02, 40/03, 42/03, 63/04, 82/04, 55/05, 81/05, 113/05, 35/06, 70/06 dhe 51/07) ministri i Arsimit dhe Shkencës solli program mësimor për lëndën *gjeografi* për klasën e VI të arsimit fillor tetëvjeçar, përkatësisht për klasën e VII për arsimin fillor nëntëvjeçar

## 1. HYRJE

Lënda mësimore që studion lëminë e shkencës së gjeografisë mësohet në periudhën e tretë (klasa e VII, VIII DHE IX) në arsimin fillor nëntëvjeçarë.

Duke e përcjellë sistematikën shkencore përkatësisht profesionale si dhe terminologjinë shkencore, si dhe karakteristikat e nxënësve dhe procesit mësimor, programet mësimore nga gjeografia janë të përpiluara ashtu që I zhvillojnë përbajtjet nga më pak të ndërlikuara kah më tepër të ndërlikuara (thellësia dhe gjerësia e njohurive rritet me moshën e nxënësve).

Mësimi i gjeografisë si lëndë mësimore ka për qëllim t'ju mundësojë nxënësve të arrijnë njohuri themelore për Tokën, rëndësinë dhe ndërlikdhjen e elementeve natyrore dhe dukuritë shoqërore si dhe proceset në botën bashkëkohore, zhvillimi dhe kujdesi I mënyrës gjeografike të mendimit dhe zhvillimit të aftësive sociale – efektive të nxënësit.

Programi mësimor nga gjeografia ndërlidhet me programet mësimore të përvetësuar paraprakisht në natyrë, shoqëri, shkencat natyrore dhe shkencat natyrore dhe teknike. Lënda mësimore gjeografisë mësohet si lëndë mësimore e detyrueshme me nga 2 orë fond javor (72 orë në vit) në klasën e VII, VIII dhe IX. Mësimi në gjeografi duhet të realizohet sipas parimeve vijuese:

- Mësimi i orientuar ndaj mësimin të nxënësit;
- Mësim i pavarur dhe hulumtim për secilin nxënës dhe perms mësimin të përbashkët në grup;
- Respektimi i parimeve të mësimin aktiv;
- Përcjellje e vazhdueshme e përparimit të secilit nxënës nga mësimdhënsi dhe dhënia e informative të rregullta për përparim;
- Vetëvlerësimi i përparimit personal të secilit nxënës

## VËREJTJE:

*Në pajtim me dinamikën për aplikimin e arsimit dhe edukimit fillor nëntëvjeçarë Programi mësimor për nxënësit e klasës së VI në arsimin fillor tetëvjeçarë në vitin shkollor 2008/09 është ekuivalent me programin mësimor për klasën e VII në arsimin fillor nëntëvjeçarë.*

## 2. QËLLIME PËR PERIUDHAT E ZHVILLIMIT NGA KLASA VII DERI IX

- të aftësohet ti njohë ligjshmerite baze universale dhe termet e gjeografisë si shkencë
- të kuptojë lidhshmerine e gjeografise me disiplinat natyrore dhe shoqërore mesimore – shkencore
- të ketë pasqyrë dhe te fitoje njohuri per objektet, fenomenet dhe proceset nepermjet shembujve konkret
- të sillet në terminologji perkatese profesionale nga sfera e gjeografise me kuptimin e domethënies
- të kuptojë dhe zbatoje distancen, teknikat dhe instrumentet per orientim në hartat fizike dhe ekonomike
- të zbulojë dhe paraqes fakte per burimet, format, gjendjet dhe ndryshimet ne hapësire
- ti analizojë dhe lidh faktorët natyror dhe shoqeror si elemente për zhvillimin e hapësirës
- të prezantojë të dhëna në numra në formë diagrami, tabela, skica dhe të dijë ti interpretojë në mesim

### 3. QËLLIMET E MËSIMIT NË KLASËN E VII

- të përpunojë dhe të propozojë plan për përpunimin e hartës tematike për aktivitete hulumtuese
- të përvetësojë njohuri dhe aftësi për zhvillimin e logjikës gjeografike – ambiente
- të fitojë njohuri për karakteristikat gjeografike të R. Maqedonisë
- të fitojë njohuri për R. Maqedonisë, si edhe për shtete të tjera si bashkësi shoqërore – politike
- të fitojë njohuri për shpërndarjen e botës bimë dhe shtazore në R. e Maqedonisë
- të fitojë njohuri për karakteristikat gjeografike të kontinenteve, religjioneve dhe shteteve në botë
- të fitojë njohuri për shpërndarjen e botës bimë dhe shtazore në Tokë
- të fitojë njohuri për popujt dhe shtetet e botës (karakteristika, ngjashmëri dhe dallime)
- të kuptojë parimet bazë për mbrojtjen e ambientit jetësor;
- të zhvillojë mendim kritik dhe ta kundërshtojë mendimin e vet me mendimin e të tjerëve;
- të veprojë dhe zbatojë hulumtime ekzakte të nxënësve për objektet natyrore, proceset dhe fenomenet
- të tregojë pjesëmarrje aktive në punën e grupit dhe në diskutime;
- të aftësohet të përdorë IKT në mesim dhe gjatë të mësuarit të gjeografisë.

Nxënësi /nxënësja:

- të fitojë njohuri për gjeografinë në Republikën e Maqedonisë dhe vendpozitën e saj në mjedisin e drejtpërdrejtë – Ballkani, Evropa dhe Bota;
- të fitojë njohuri për karakteristikat natyrore – gjeografike të Republikës së Maqedonisë (pozita gjeografike, relievi, klima, hidrografia, bota bimë dhe shtazore);
- të fitojë njohuri për karakteristikat socio – gjeografike të Republikës së Maqedonisë (popullata, lagjet);
- të fitojë njohuri për karakteristikat ekonomike – gjeografike të Republikës së Maqedonisë.

## 4. QËLLIMET KONKRETE

### TEMA: KARAKTERSITIKAT NATYRORE – GJEOGRAFIKE TË R. SË MAQEDONISË – 28 orë

Qëllime	Përmbajtje	Koncepte	Aktivitete dhe metoda
<p>Nxënësi/nxënësja:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- të njihet me vendpozitën e R. së Maqedonisë (mjedisi i drejtpërdrejtë, kufijtë e saj dhe madhësia);</li> <li>- të aftësohet t'i emëroj shtetet fqinje dhe të jep përshkrim për vijën kufitare;</li> <li>- të aftësohet ta përshkruaj strukturën relievike të RM;</li> <li>- të aftësohet t'i sqarojë dallimet ndërmjet maleve të vjetra gramade dhe maleve të reja vargore;</li> <li>- të fitoj njohuri për hapsirën e fushgropave dhe grup malesh lindjes – vardarit;</li> <li>- të fitojë njohuri për Fushgropën kompozite të Lumit Vardar;</li> <li>- të fitojë njohuri për vendet e sharrit dhe Pellagonisë;</li> <li>- të fitojë njohuri për faktorët klimatik dhe ndikimin në hapësirë;</li> <li>- Të njihet me formimin dhe rëndësinë e ujërave nëntokësor dhe burimeve;</li> <li>- Të fitojë njohuri për hidrografinë në R. e Maqedonisë;</li> <li>- Të aftësohet t'i tregoj në hartë lumenjtë dhe rrjedhat e lumejve;</li> </ul>	<p><b>Pozita gjeografike</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Kufijtë dhe madhësitë</li> <li>- Pozita gjeografike dhe e komunikacionit</li> </ul> <p><b>Relievi</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Struktura relievike dhe karakteristikat e relievit të RM</li> <li>- Grupi i Fushgropave dhe maleve Lindore – të Vardarit;</li> <li>- Maqedonia e Ulët</li> <li>- Fusha e Pellagonisë</li> <li>- Vendi karakteristik i Sharrit</li> </ul> <p><b>Klima</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Faktorët klimatik</li> <li>- Karakteristikat dhe specifikat e elementeve meteorologjike dhe llojeve klimatike në R. e Maqedonisë</li> </ul> <p><b>Hidrografia</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Ujërat nëntokësor dhe burimet</li> <li>- Lumenjtë dhe pellgjet e lumenjëve</li> <li>- Liqene</li> </ul>	<p>Kufiri Vija kufitare Kalimi kufitar Republika etnike</p> <p>Struktura relievike Pjesa rodope Vargore Fushgropa Kompozite Klisura Tektonika Gropa Shpella Relievi vullkanik</p> <p>Koha Klima Temperatura Rreshjet Termometri Celziosi Barometri Hidrografia Burimi Pellg lumi</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Vëzhgimi, përdorimi i hartës fizike të R. së Maqedonisë për përshkrimin e vijës kufitare.</li> <li>- Vëzhgimi I hartës dhe përdorimi i videoshkresave dhe CD për strukturën e relievit.</li> <li>- Grupimi i materialeve të grumbulluara dhe të shkruara për relievin.</li> <li>- Identifikimi i hartës relievike të nocionit fushgropa kompozite e Lumit Vardar.</li> <li>- Bisedë për krijimin dhe dukjen e pjesës së Sharit.</li> <li>- Vizita e stacionit meteorologjik.</li> <li>- Përpilim hartë klimatike me grafikone për llojet klimatike në R. e Maqedonisë.</li> <li>- Demonstrimi i përpilimit të hartave tematike, hidrogrameve për regjimin e lumit të lumenjëve më të mëdhenjë.</li> <li>- Të shikuarit e fotografive dhe CD për pellgun e Lumit Vardar dhe Drini i Zi.</li> </ul>

Qëllime	Përmbajtje	Koncepte	Aktivitete dhe metoda
<ul style="list-style-type: none"> <li>- të njihet me formimin dhe rëndësinë e ujërave nëntokësor dhe burimet;</li> <li>- të fitojë njohuri për hidrografinë në R. e Maqedonisë;</li> <li>- të aftësohet t'i shpreh në hartë lumenjtë dhe pellgjet e lumenjëve;</li> <li>- të fitojë njohuri për rëndësinë ekonomike të liqeneve;</li> <li>- ta kuptojë rëndësinë për klasifikimin e tokave dhe rëndësia e tyre ekonomike në R. e Maqedonisë;</li> <li>- të fitojë njohuri për ndërlvarshmërinë e klimës, ujërave, botës bimore dhe shtazore.</li> </ul>	<p><b>Bota bimore dhe shtazore</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Bota bimore</li> <li>- Bota shtazore</li> </ul> <p><b>Përbërja pedologjike</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Llojet e tokës dhe përhapja e tyre territoriale në R. e Maqedonisë</li> </ul>	<p>Koritë lumi Regjim lumi Lumë nëntokësor</p> <p>Kullosa Algat Vegjetacioni</p> <p>Pedologjia Tokët aluviale Podzol Smolnica Humus Crvenica</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Bisedë me nxënësit për llojet e bashkësive të ndryshme bimore dhe shtazore.</li> <li>- Përpunimi i një përbledhje të ndryshme të llojeve të tokave.</li> <li>- Përdorimi i kompjuterit, Internetit dhe kompakt disqet me përmbajtje gjeografike.</li> <li>- Realizimii mësimi në terren në afërsi të drejtpërdrejtë në vendbanim.</li> </ul>

**TEMA: KARAKTERISTIKA SOCIO-GJEOGRAFIKE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISE – 12 ORË**

Qëllime	Përmbajtje	Koncepte	Aktivitete dhe metoda
<p>Nxënësi/nxënësja:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- te njihet se si faktoret natyror dhe te tjera ndikonin mbi popullimin e R. e Maqedonise;</li> <li>- të aftesohet ti interpretojë karakteristikat demografike bazë nëpërmjet skemave zgjedhore, grafikeve dhe diagrameve;</li> <li>- të njihet me levizjet emigruese të popullatës maqedonase jashtë kufijve të Republikës së Maqedonisë;</li> <li>- të njihen me ndarjen territoriale dhe ambientin lokal gjeografik në R. e Maqedonisë;</li> <li>- të njihet me ndarjen bazë të vendeve të banuara;</li> <li>- te njihet me vendimet baze te vendbanimit te qytetit;</li> <li>- të aftesohet ti tregoj ne harte vendbanimet qytete dhe ti identifikojë sipas shenjës hartografike për numrin e banorëve;</li> <li>- të njihet me karakteristikat bazë gjeografike të qytetit të Shkupit si kryeqytet i R. së Maqedonise;</li> <li>- të njihet me pamjet fizionomike dhe demografike të fshatrave.</li> </ul>	<p><b>Popullata</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Popullimi</li> <li>- Karakteristika demografike:</li> <li>Levizje e popullatës, dendësia, rritja natyrore dhe struktura e popullatës (gjinia, mosha dhe etniteti)</li> <li>- Lëvizje emigruese ndarja territoriale dhe ambienti lokal gjeografik</li> </ul> <p><b>Vendbanime</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- zhvillim funksional dhe shprehje fizionomie të vendbanimeve</li> <li>- vendbanime qytetare dhe fshatare në R. e Maqedonisë</li> </ul>	<p>Dendësia e popullatës Rritja natyrore Emigrime Migrime Imigrime</p> <p>Administrativ</p> <p>Ambient urban Ambient rural</p> <p>Tip i mbyllur</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Shqyrtimin e hartës për karakteristikat demografike në R.e Maqedonisë.</li> <li>- Demonstrimin e hartave tematike për dendësinë dhe rritjen natyrore në rajone të caktuara.</li> <li>• Përpunimin e grafikeve për levizjen e popullatës, për strukturën gjinore, të moshës dhe etnike.</li> <li>• Hulumtim, analizë dhe përpunim të hartës tematike për shtrirjen e popullatës maqedonase jashtë kufijve të R. e Maqedonisë.</li> <li>.</li> <li>• Hulumtim të dallimeve ne funksionalitetin dhe fizionominë midis vendbanimeve urbane dhe rurale .</li> <li>• Përpunimi i foto albumit nga fotografi të mbledhura për Shkupin, Manastirin, Tetovën, Ohrin etj.</li> </ul>

**TEMA: KARAKTERISTIKA EKONOMIKE - GJEOGRAFIKE E R. E MAQEDONISE – 32 ORE**

Qëllime	Përmbajtje	Koncepte	Aktivitete dhe metoda
<p>Nxenesi/nxenesja:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- të njihet me faktorët natyror dhe kushtet ekonomik-shoqërore për zhvillim të ekonomisë;</li> <li>- të njihet se si faktorët natyror ndikojnë mbi zhvillimin e ekonomisë;</li> <li>- të njihet me degët ekonomike dhe prodhimtarinë e tyre;</li> <li>- të njihet me karakteristikat e bujqësisë si degë ekonomike primare;</li> <li>- të njihet me prodhimin bujqësor dhe klasifikimin e prodhimeve bujqësore;</li> <li>- të njihet me rajonizimin e kulturave bujqësore të R. e Maqedonisë</li> <li>- të njihet me prodhimin e prodhimeve të pëmetarise dhe vreshtarisë;</li> <li>- të njihet me blegtorinë dhe pylltarinë;</li> <li>- Te aftësohet ti tregojë hartë hidrocentrale në RM;</li> <li>- të fitojë njohuri për gjetjet dhe prodhimin e qymyrit në RM;</li> <li>- të fitojë njohuri për burime të tjera të energjisë që mund të përdoren.</li> </ul>	<p><b>Ekonomia dhe degët ekonomike në R. e Maqedonisë</b>                      Ndikimi i faktoreve natyror dhe kushteve shoqërore-ekonomike për zhvillim të ekonomisë;                      - ekonomia dhe degët ekonomike sot</p> <p><b>Bujqësi</b>                      - karakteristika të përgjithshme të bujqësisë dhe fondit të tokave;                      - bujqësi;                      - pëmetari dhe vreshtari;                      - blegtori dhe fond blegtoral;                      - pylltari, gjueti dhe peshkim.</p> <p><b>Energji dhe zbulime minerale</b>                      - vëllimi i shtrirjes së potencialit hidroenergetik.                      - Zbulime dhe prodhim i qymyrit;                      - burime të tjera të energjisë.</p>	<p>Ekonomi                      Dege ekonomike</p> <p>Bujqësi                      Fond bujqësor                      Prodhime bujqësore                      Pëmetari                      Vreshtari                      Blegtori                      Fond blegtoral pylltari</p> <p>Energji                      Hidroenergji                      Potencial energjetik                      Energji diellore</p> <p>Industri bazë                      Industri për konsum të gjërë</p>	<p>Hulumtim për ndikimin e faktorëve natyror dhe kushteve shoqërore – ekonomike për zhvillim të ekonomisë.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Mbikëqyrje dhe analizë të hartës ekonomike për shpërndarjen dhe dendësinë e degeve ekonomike .</li> <li>• Përpunimin e hartave tematike për shpërndarjen e bujqësisë, pëmetarise dhe vreshtarise.</li> <li>• Hulumtim: pemë, vreshti i verës dhe përpunimi i tyre në kapacitetet prodhuese.</li> <li>• Vizitë e fermës blegtorale ose fabrikë prodhuese e qumështit dhe prodhimeve të qumështit.</li> <li>• Përpunimin e postereve për shpërndarjen e fondit të pyjeve .</li> <li>• Bisedë me nxënësit për domethënien e energjisë për zhvillimin e ekonomisë.</li> <li>• Përpunimin e hartave tematike për shpërndarjen e potencialeve energjetike në R. e Maqedonisë.</li> </ul>



Qëllime	Përmbajtje	Shembuj	Aktivitete dhe metoda
<p>- të njihet me ndarjen e degëve të industrisë (industria e rënde dhe e lehtë);</p> <p>- Të njihet me disa degë më të rëndësishme industriale të RM;</p> <p>- të njihet me artizanatin dhe ndërtimtarine në RM ;</p> <p>- të fitojë njohuri baze per qarkullimin si shërbim konsumator;</p> <p>- të njihet me faktorët për zhvillim dhe zgjerim të rrjetit të komunikimit;</p> <p>- të kuptojë domethenien e degëve të caktuara të komunikimit;</p> <p>- të fitojë njohuri bazë për tregtinë si shërbim konsumator;</p> <p>- të njihet me domethenien e këmbimit tregtar me vende të tjera në botë;</p> <p>- të fitojë njohuri baze per tregtine si shërbim konsumator - të njihet me faktorët për zhvillim të turizmit.</p> <p>- të fitoje njohuri per karakteristikat e vendeve më të njohura të turizmit veror dhe dimëror të RM.</p>	<p><b>Industri</b> Karakteristika bazë të industrisë dhe degëve industriale</p> <p>- Industria bazë e rëndë</p> <p>- industria për konsum të gjërë në RM</p> <p>- Zejtari dhe ndërtimtari</p> <p><b>Komunikacion</b> Kriteret, komoditet dhe parime për formimin e rrjetit të komunikacionit</p> <p>- Degët e komunikacionit</p> <p><b>Tregti</b> - Tregti e brendshme dhe e jashtme</p> <p><b>Turizëm</b> - Faktorë për zhvillimin e turizmit dhe vende turistike në R. e Maqedonisë</p>	<p>Industri bazë Industri për konsum të gjërë</p> <p>Zejtari Ndërtimtari</p> <p>Rrjet qarkullimi Degë qarkullimi</p> <p>Tregti Eksport Import</p> <p>Turizem Hotelieri</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Demonstrimin e fotografive, grafikeve etj., për kapacitetet prodhuese industriale.</li> <li>• Shqyrtimin e materialit të mbledhur për zejtarinë dhe ndërtimtarine ne te kaluarën dhe sot.</li> <li>• Bisedë me nxënësit për përparësitë dhe faktorët negativ për zhvillim të rrjetit të qarkullimit.</li> <li>• Përpunimin e hartës tematike për dendësinë e rrjetit të qarkullimit.</li> <li>• Shqyrtimin e sllajdeve dhe paraqitjes së CD-ve me peizazhe dhe objekte turistike.</li> <li>• Vizitën e objektit të njohur turistik të afërt në afërsi të drejtpërdrejtë.</li> </ul>

## 5. REKOMANDIM DIDAKTIK

Në programin mësimor është dhënë planifikim orientues i orëve të mësimit për temat dhe qëllimet mësimore. Megjithatë, kuadri mësimor duhet fondin e orëve ta planifikoj vet për realizim të plote dhe të suksesshme të qëllimeve të përcaktuara nga programi.

- Rekomandohet përdorimi i këtyre mjeteve mësimore:
  - libër i zgjedhur në nivel të shkollës për lëndën përkatëse, i caktuar nga ministri
  - burime të tjera të të mësuarit në rrethinën e afërt – objekte dhe dukuri natyrore
  - enciklopedi, atlase etj
  - internet, softuere mesimor
  - revista
  - mjete audio – vizuale

Teknologjia bashkohore didaktike në mësim në gjeografi përveç përdorimit të hartave të ndryshme gjeografike, jep mundësi të shkëlqyera për përdorimin e kompjuterit, përkatësisht përdorimin e gjerë të gjeoinformatikës në mësimin në gjeografi. Megjithatë, duke parë sipas moshës së nxënësve si mjet mësimor më produktive do të jetë përdorimi i hartave fizike – gjeografike të Republikës së Maqedonisë, përdorimin e hartës së relievit të Republikës së Maqedonisë, më pas harta fizike e Gadishullit Ballkanit dhe Evropës, përdorimin e hartës administrative – territoriale të Republikës së Maqedonisë, të hartës ekonomike të Republikës së Maqedonisë, përdorimin e hartave të ndryshme tematike për Republikën e Maqedonisë (gjeologjike, hidrologjike, pedologjike, të qarkullimit, turistike etj). Gjithashtu, gjatë mësimit mund të përdoren edhe harta memece, leximi gjeografik, doracak për gjeografi, prospekte të ndryshme etj.

## 6. VLERËSIMI I TË ARRITURAVE TË NXËNËSVE

Gjatë mësimit rregullisht ndiqen dhe vlerësohen arritjet e nxënësve, mbledhen tregues për aktivitetet e tyre, motivimi për të mësuar, bashkepunimi me të tjeret etj. (vlerësimi formativ). Gjithashtu, rregullisht kryhet informimi i çdo nxënësi, si edhe i prindërve për përparimin e nxënësit. Kjo komponente është pjesë përbërëse e planifikimit të mësuesit për mësimin dhe mësimdhënien.

Rekomandohet të përdoren këto mënyra të ndjekjes, kontrollimit dhe vlerësimit të arritjeve të nxënësve në kuadër të temave mësimore.

- me gojë;
- praktikë (tentime, ushtrime etj);
- pjesëmarrje në hulumtim dhe prezantim.

*Nxënësit vlerësohen me nota numerike.*

## 7. KUSHTE HAPËSINORE PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT MËSIMOR

Programi në lidhje me kushtet e ambientit bazohet në Normativin për hapësirë, pajisje dhe mjete mesimore për arsimin fillor nëntëvjeçarë të caktuar nga ministri i Arsimit dhe Shkencës me vendim nr. 07-1830/1 nga data 28.02.2008

## 8. NORMATIVA E KUADRIT MËSIMOR

Mësimin për gjeografi për klasën e VII mund ta kryejë person i cili ka mbaruar:

- studime për gjeografi, drejtimi mesimor, 7<sup>1</sup>;
- SHLN, grupi histori dhe gjeografi (te cilet tani me realizojne mesimdhënie ne shkollat fillore).

Programin mësimor për lëndën e *gjeografisë* për klasën e VI në arsimin fillor tetëvjeçar, përkatesisht për klasën e VII, VIII ose të IX në arsimin fillor nëntëvjeçarë e caktoi ministri i Arsimit dhe Shkencës nr. 07-2330/1 prej 15.03.2008.